



BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 22, datë 23.05.2016

Për

“MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM PA KUNDËRSHPËRBLIM, TË 100 M², TË PASURISË “SHESH”, AKADEMISË SË SHKENCAVE”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 26, nenit 54, shkronja “e” dhe nenit 55, pika 4 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetqeverisjen vendore”; nenit 901 e vijues të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 6 të Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 31.07.2013 për “Miratimin e listës së pjeshme të inventarit (pjesa e tretë, e katërt dhe e pestë) të pronave të paluajtshme në Bashkinë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 23.09.2015 “Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”; shkresës së Akademisë së Shkencave me nr. prot. 352/2, datë 21.12.2015 (protokolluar pranë Bashkisë së Tiranës me nr. prot. 22046, datë 21.12.2015) dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Tiranë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim pa kundërshtpërblim, të 100 m², të pasurisë “shesh”, me nr. pasurie. 2/41, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8380, me indeks harte TR-T-13, Akademisë së Shkencave, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi, për 10 vite.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI